

ALBANIAN UNIVERSITY

## RAPORT VJETOR INSTITUCIONAL

Viti Akademik 2022 - 2023

*AU - DHJETOR - 2023*



## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

### HYRJE

“Albanian University” është institucion privat, i pavarur dhe ndër Universitetet e para private të hapura në Republikën e Shqipërisë me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.197, datë 10.04.2004 dhe prej më shumë se një dekade operon me 3 (tre) Njësi Kryesore (Fakultete):

1. Fakulteti i Shkencave Mjekësore
2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3. Fakulteti i Shkencave Shoqërore

Për vitin akademik 2022-2023, “Albanian University” ka aktive 41 programe studimi, prej të cilave 15 janë programe Bachelor, 12 programe Master Profesional, 7 programe Master i Shkencave, 4 Programe të Integruara të Nivelit të Dytë, 2 programe në Specializim Afatgjatë, 1 program me karakter profesional (Laborant i Lartë Dentar).

Risi është programi i ri, Master i Shkencave, program i integruar në “Odontoiatria e Protesi Dentaria” i përbashkët me Universitetin e Ferrarës, i cili është aktiv për herë të parë ku janë regjistruar 20 studentë të huaj, i miratuar me Urdhër Ministri MAS Nr.444 dt 22.07.2022.

Ky bashkëpunim vjen gjithashtu në përmbushje të objektivave kombëtare për ndërkombëtarizimin e universiteteve shqiptare.

Albanian University ka kaluar me sukses akreditimin institucional duke u vlerësuar pozitivisht nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në Shqipëri në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë (QAA), shprehur me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 55, datë. 26.05.2023, i vlefshëm deri në datë 25.05.2027 dhe gjithashtu u aplikua për riakreditimin e 15 programeve të studimit.

Programet e studimit të ofruara nga “Albanian University” janë hartuar dhe zhvillohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke përmbushur standardet shtetërore të cilësisë.

Për këtë vit akademik është aplikuar për hapjen e dy programeve të reja studimi si dhe për programin e studimit të ciklit të tretë: Doktoratë (hapje dhe riorganizim).

Për vitin akademik 2022-2023 është rritur numri i aplikimeve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare nga stafi akademik si dhe numri i mobiliteteve si të studentëve dhe stafit akademik me Institucione të tjera të huaja të Arsimit të Lartë me qëllim shkëmbimin e eksperiencave për përmirësimin e cilësisë në procesin e mësimdhënies.

Më poshtë paraqitet raporti vjetor për universitetin privat “Albanian University” për vitin akademik 2022 - 2023, mbështetur në pikat e udhëzimit nr.5, datë 19.02.2018 të MAS Përcaktimit e Elementëve Përbërës të Raportimit Vjetor dhe Afatit për Raportim të Institucioneve të Arsimit të Lartë” i ndryshuar me Udhëzimin nr.24 datë 21.10.2019, si dhe referuar nenit 102 të Kushtetutës, nenit 32, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.



## Përmbajtja

A. Senati Akademik .....	5
a. Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së .....	5
b. Informacion mbi bashkëpunime ndërinstucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.....	6
c. Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin: .....	15
i) politikat e kërkimit shkencor .....	15
ii) të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien .....	17
iii) produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësia bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit. ....	17
Marrëveshjet e bashkëpunimit ndërinstucional për vitin 2022-2023 dhe në vazhdim.....	28
iv) Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor .....	44
d. Të dhëna mbi programet e studimit .....	48
i) IAL-ja informon mbi të gjitha programet e studimit që ofron, përfshirë ato ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, nëse ka. Në raport paraqiten programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, për të cilën/cilat është marrë leje për hapjen e tij/tyre, por nuk është aktivizuar	48
ii) IAL-ja informon mbi marrjen e lejes për hapjen e programit të studimit që është në proces vlerësimi, si dhe për programe që ofrojnë formim të vazhdueshëm për të tretë apo për zhvillimin profesional të personelit të tyre. Këto të dhëna shoqërohen me numrin dhe datën e aktit për hapjen, për pezullimin ose për mbylljen e programit të studimit.....	60
iii) IAL-ja pasqyron në raportin vjetor përshtatshmërinë e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimin e synimeve të programit të studimit nga ana e përmbajtjes dhe lidhjen e rëndësishme e programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës	61
e. Ndryshimet në statutin apo rregulloret e IAL-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. ....	62



## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

- f. Parashikimin për angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe/ose modulën/et që do të zhvillojë secili prej tyre për secilin semestër të vitit akademik .....63
- g. Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që IAL-të ofrojnë, të shoqëruar me burimin e informacionit dhe adresën ku konfirmohet informacioni, duke specifikuar: .....65
- i) përqindjen e punësimit të të diplomuarve, nëse institucioni deklaron se programet e ofruara përgatisin për një karrierë apo profesion të caktuar; .....65
  - ii) përqindjen e të diplomuarve që kalojnë provimin e shtetit dhe licencohen, kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar .....74
- h. Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë .....75
- i. Vlerësime të IAL-së dhe rekomandime të mundshme për ministrinë, si dhe një përshkrim të ndërveprimit të IAL-së me strukturat e varësisë të ministrisë, duke përfshirë edhe: .....77
- i) një vlerësim të përgjithshëm të komunikimit me ministrinë dhe institucionet në varësi të saj, duke theksuar mbi përmirësimet e mundshme në këtë komunikim; .....77
  - ii) vlerësime dhe rekomandime për ndryshime të sistemit apo akteve ligjore e nënligjore në fuqi që ndikojnë në veprimtarinë e IAL-së, të shoqëruar me arsyetime të hollësishme.....77
- j. Të dhëna mbi studentët si: .....78
- i) numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit;.....78
  - ii) numrin e studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar, të përcaktuar në dokumentin e prioritetëve të miratuar dhe të publikuar çdo vit nga ministria sipas drejtimeve kryesore. ....78
  - iii) numrin e studentëve të shkëlqyer; .....78
  - iv) numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen;78
  - v) numrin e studentëve që kanë përfituar bursa dhe numrin e atyre që kanë përfituar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit .....78
  - vi) pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre .....85
  - vii) përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen e atyre që diplomohen .....85
  - viii) një vlerësim të përgjithshëm mbi cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi .....85
- B. Bordi i Administrimit:** .....86
- a. Të dhëna të përgjithshme mbi IAL-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit të arsimit të lartë, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse, etj. ....86



## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

- b. Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit ..... 86
- c. Realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim 87
- d. Dokumentacionin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore .....87
- e. Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare .....87
- f. Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen ndryshime në mjediset didaktike, kërkimore, politika të shpërndarjes së fondeve në funksion të përmirësimit të cilësisë, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin, në bashkëpunim me Senatin Akademik të institucionit të arsimit të lartë.....89



## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

### A. Senati Akademik:

a) *Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së.*

Plani Strategjik Institucional është dokumenti i planifikimit që përshkruan misionin, objektivat strategjike dhe akademike të Universitetit.

Në mbështetje të Planit Strategjik Institucional 2023 - 2028 në "Albanian University", i cili ka në fokus përmbushjen e misionit të institucionit, por edhe ruajtjen e vazhdimësisë së objektivave të hartuara nga "Plani Strategjik 2017-2022.

Për vitin akademik 2022-2023, i cili përkon me vitin e parë të implementimit të planit strategjik të ri (2023-3038) qëllimet dhe objektivat kryesore të mësimdhënies janë përmbushur në mënyrë cilësore, nisur edhe nga raportet e njësive bazë dhe njësive kryesore.

Gjithashtu, është punuar në mënyrë të vazhdueshme për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënie, kjo falë edhe trajnimeve të realizuara me stafin akademik, me profesorë vendas dhe të huaj me fokus metodat bashkëkohore të mësimdhënies. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar *feedback*-ut të marrë nga studentët (nëpërmjet realizimit të pyetësorëve 2 herë në vit dhe fokus grupeve një herë në vit) si dhe *feedback*-ut nga pedagogët (nëpërmjet pyetësorëve drejtuar stafit akademik për të marrë informacion mbi përshtypjen e tyre ndaj institucionit).

Analiza e pyetësorëve, si në nivel Universiteti, ashtu edhe njësive bazë, ka qëllim të promovojë praktikën e mira, të nxisë vazhdimësinë e tyre, dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.

Gjatë vitit akademik 2022 - 2023, është zhvilluar gjithashtu një pyetësor mbi "Lumturinë në punë" drejtuar stafit akademik dhe administrativ të Universitetit.

Në kuadër të realizimit të objektivave të mësimdhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë AU ka implementuar raportin vjetor të vetëvlerësimit të programeve të studimit, në mënyrë që të evidentohen informacione në lidhje me progresin e programeve dhe pikat ku ka nevojë për përmirësim në të ardhmen.

Për sa i përket kërkimit shkencor, fushë e cila mbulohet nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike, informacioni implementohet nëpërmjet formularit të veprimtarisë kërkimore shkencore si dhe pjesëmarrjes nëpër projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.



RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

b) *Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.*

**Projekte të fituara**

Tabela 1

Nr	Data aplikuar	TITULLI I PROJEKTIT	THIRRJA	DONAT ORI	INSTITUCIONI APLIKUESE	STADI	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT
1	rinovuar 22.02.2022	KA 1 - Higher Education Student and Staff mobility në bashkëpunim me Universitetin e Salernos, Itali	Erasmus +	BE	Departamenti i Inxhinierive	Projekti fituar	2 mobilitete të studentëve për të zhvilluar mësimin gjatë semestrit të dytë të v.a. 2022 - 2023
2	rinovuar 15.11.2021	Erasmus+ KA107 në bashkëpunim me University of Jyväskylä, Finland	Erasmus +	BE	Departamenti i Inxhinierive	Projekti fituar	3 mobilitete të studentëve për praktikë dhe 2 mobilitete të stafit akademik gjatë semestrit të dytë
4	Shkurt 2020	2020-1-TR01-KA107-085710 Erasmus+ KA107 në bashkëpunim me Biruni University, Turqi	Erasmus+	BE	Departamenti i Inxhinierive	Projekti fituar	Shkëmbime të ndërsjellta të stafit dhe studentëve
5	17.11.2022	Erasmus+ KA171 në bashkëpunim me The Arctic University of Norëay	Erasmus+	BE	Departamenti i Inxhinierive	Projekti fituar	Shkëmbime të ndërsjellta të stafit dhe studentëve
6	31.01.2023	ERASMUS-EDU-2023-EUR-UNIV - NEOLAiA - Transforming Regions for an Inclusive Europe	Erasmus+	BE	Departamenti i Inxhinierive	Projekti fituar	NEOLAiA është një projekt që synon të kultivojë dhe zgjerohet njohuria në një aleancë të ngushtë të nëntë institucioneve të reja arsimit të lartë dhe në zhvillim dinamik, të bazuar në qytete të vogla dhe të mesme në katër rajone evropiane përtej metropolitëve. AU është partner i asociuar duke kontribuar në



RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

							zhvillimin e aktiviteteve.
7	28.02.2023	ERASMUS-EDU-2023-CB-VET - DUAL LEARNING FOR ALBANIA	Erasmus+	BE	Departamenti i Inxhinierive	Projekt i fituar	ZAL.L synon të adresojë çështjet me Arsimin dhe Trajnimin Profesional (VET) në Shqipëri, me një referim të veçantë në sektorin e turizmit-rural, dhe duke u bazuar në prioritetet e Fondit Evropian të Trajnimit (ETF) për zhvillimin e kapitalit njerëzor në vend.
8	15.03.2023	PKKZH 2023 - Rëndësia e aplikimit të indikatorëve kohë-temperaturë (TTI-ve) si monitorues të cilësisë së produkteve ushqimore të ambalazuara përgjatë zinxhirit ftohës	Projekte Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit PKKZH	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit AKKSHI	Albanian University-Departamenti i Inxhinierive	Projekt i fituar	Partner. Koordinator Universiteti Bujqësor i Tiranës
9	29.03.2023	HORIZON-CL4-2023-HUMAN-01-64 - Agile and Flexible Construction Materials Standardization for Boosting the Twin Transition	HORIZON	BE	Departamenti i Inxhinierive	Projekt i fituar	
10	24.04.2023	Empowering Early-stage Start-ups	EU4Innovation	BE	Departamenti Art Dizajnit	Projekt i fituar	Zhvillimi i start up-ve





RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

Projekte të aplikuara

Tabela 2

Nr	Data aplikuar	Titulli i projektit	Thirrja	Donatori	Institucioni Aplikues	Stadi	Përshkrimi Projektit
1	16.02.2023	ERASMUS-EDU-2023-CBHE-STRAND-1 Research Universities	Erasmus+	BE		<i>Aplikuar-Refuzuar</i>	
2	16.02.2023	ERASMUS-EDU-2023-EMJM-DESIGN Master of Gender and Digital Education	Erasmus+	BE	University of Sousse-Tunisia	<i>Aplikuar - Refuzuar</i>	Joint Master në edukimin e barazisë gjinore për tu dhënë studentëve një kuptim të gjerë të kryqëzimit të gjinisë dhe teknologjisë në arsim, do të zhvillojë aftësitë e tyre të mendimit kritik dhe aftësinë për të analizuar dhe vlerësuar përfaqësimin dhe portretizimin e gjinisë në media e teknologjinë educative.
3	28.02.2023	ERASMUS-EDU-2023-CB-VET Stairway to quality and valuable opportunities in VET	ERASMUS-LS	BE		<i>Aplikuar - Refuzuar</i>	
4	28.02.2023	ERASMUS-EDU-2023-CBHE-STRAND-1	ERASMUS-LS	BE		<i>Aplikuar -</i>	



RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

		Improve education and university staff for understanding and managing students stress				Refuzuar	
5	28.02.2023	ERASMUS-EDU-2023-CB-VET Good Industry 4.0 Practices Shared in the Western Balkan	ERASMUS-LS	BE		Aplikuar - Refuzuar	
6	07.11.2022	ALbeanIT Makarona të fortifikuara me miell nga varietetet shqiptare të fasuleve: Aktivitet frenues kundër enzimave që tresin karbohidratet/ Pasta Fortified with Flour from Albanian Bean Varieties: Inhibitory Activity against Carbohydrate Digesting Enzymes	Projekte Bilaterale Shqipëri-Itali	CNR-AKKSHI 2022	Albanian University, AU - Centro Nazionale della Ricerca, IT	Aplikuar - Refuzuar	Krijimi i produkteve ushqimore të tipit të makaronave të fortifikuara me miell të derivuar nga fasulet për të kundërshtuar enzimat që tresin karbohidratet.
7	16.11.2022	HORIZON-CL4-2022-HUMAN-02-01 SueApp EU	HORIZON-RIA	BE		Aplikuar - Refuzuar	
8	03.03.2023	FAGRRE Analiza e fizibilitetit të ripërdorimit të gjelbër të ujërave të shiut/Feasibility analysis of green	Projekte Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit PKKZH	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit AKKSHI	Albanian University	Aplikuar - Refuzuar	Studim në rajonin e Tiranës mbi mundësinë e ripërdorimit të shirave në mjediset shtëpiake.



RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

		rainwater recycling					
9	06.03.2023	Turizmi Religjioz elektronik: Vendet religjioze & Pelegrinazhet e Shqipërisë/e-Religious Tourism: Religious sites & Pilgrimages of Albania	Projekte Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit PKKZH	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit AKKSHI	Logos University, Albanian University	Aplikuar - Refuzuar	Studim mbi mundësinë e dixhitalizimit të turizmit religjioz në territorin e Shqipërisë në kuadër të promovimit të turizmit dhe siteve arkeologjike fetare apo të pelegrinazhit.
10	15.03.2023	Micro-Credentials for Inclusive Employability: Building Innovative Solutions for the European Labour Market	ERASMUS-EDU-2023-PI-FORWARD-LOT2	BE		Aplikuar - Refuzuar	
11	15.03.2023	ERASMUS-EDU-2023-PI-FORWARD-LOT1 Development of an artificial intelligence virtual testing laboratory for the development of the educational process	ERASMUS-EDU-2023-PI-FORWARD-LOT1	BE		Aplikuar - Refuzuar	
12	17.03.2023	Identifikimi i praktikave për sigurinë kibernetike në shkolla, universitete e qendra kerkimore dhe analiza e tyre për të gjetur, rekomanduar dhe përgjithësuar	Projekte Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit PKKZH	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit AKKSHI	Albanian University, Akademia e Forcave të Armatosura	Aplikuar - Refuzuar	Realizim i identifikimit të praktikave për sigurinë kibernetike në ambientet shkollore në territorin e e Shqipërisë.



**RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023**

		metodologjitë me të mira teorike dhe praktike					
1 3	17.03.2023	Efekti Citotoksik dhe antitumoral i disa bimëve të vendit tonë	Projekte Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit PKKZH	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit AKKSHI	Albanian University	<i>Aplikuar - Refuzuar</i>	Projekt mbi studimin e efektit citotoksik dhe antitumoral të bimëve që rriten në territorin e Shqipërisë.
1 4	17.03.2023	Përfitimet e veprimit fizik në shkatërrimin e biofilmit bakterial në peri-implantite	Projekte Kombëtare të Kërkimit e Zhvillimit PKKZH	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit AKKSHI	Albanian University	<i>Aplikuar - Refuzuar</i>	Projekt mbi realizimin në fushën e dentistrisë në studimin e dedektimit të përfitimeve veprimit fizik në shkatërrimin e biofilmit bakterial në peri-implantite
1 5	20.03.2023	CAPACITY BUILDING FOR ADAPTED JUDO	ERASMUS-SPORT-2023-CB	BE	National University of Physical Education and Sport, Bucharest, Romania	<i>Aplikuar - Refuzuar</i>	Projekt për të zhvilluar aftësitë e organizatave partnere, të nevojshme për të rritur integrimin shoqëror dhe përfshirjen e njerëzve me nevoja të veçanta (të cilët kanë spektrin e autizmit dhe Sindromën Down) duke praktikuar



RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

							judon e përshtatur.
1 6	21.03.2023	Online Earthquake Awareness Training Course for Architecture/Interior Architecture Students	Erasmus KA220-HED	BE	Akdeniz University, Turkiye	Aplikuar - Refuzuar	Projekt i cili përfshin zhvillimin dhe përgatitjen e moduleve, synon të përmirësojë nivelet e njohurive dhe ndërgjegjësimin të studentëve të arkitekturës dhe interior dizajn. Gjithashtu, sistemi digjital që do të ndërtohet do të testohet dhe zhvillohet në bashkëpunim me partnerët.
1 7	23.03.2023	English Ecosystem Project: An Intercultural, Communicative Language Learning Model with a Digital Language Learning Platform	Erasmus KA220-HED	BE	SAKARYA UNIVERSITESI	Aplikuar - Refuzuar	Projekt me qëllim krijimin e një Ekosistemi të mësimin të gjuhëve përmes një modeli me Platformë digjitale.
1 8	12.04.2023	Boosting the Centre of Excellence on Nanoscience and Nanotechnology for Albania and the Western Balkans	HORIZON-WIDERA-2023-ACCESS-01-01-two-stage	BE	Albanian University	Aplikuar - Refuzuar	Nxitja e Qendrës së Ekselencës në Nanoshkencë dhe Nanoteknologji për Shqipërinë dhe Ballkanin Perëndimor.



### RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

19	14.04.2023	Environmental Perception Management	HORIZON-CL5-2023-D1-01-09	BE		Aplikuar - Refuzuar	
20	19.04.2023	Interconnect: Virtual Language and Cultural Exchange Project	ERASMUS-EDU-2023-VIRT-EXCH	BE		Aplikuar - Refuzuar	
21	26.04.2023	Fostering Cultural Understanding and Collaboration in the Western Balkans and Beyond	ERASMUS-EDU-2023-VIRT-EXCH	BE		Aplikuar - Refuzuar	
22	26.04.2023	Promoting Youth CSO Entrepreneurship in the field of Distance Education Industries	ERASMUS-EDU-2023-VIRT-EXCH	BE		Aplikuar - Refuzuar	
23	01.05.2023	Thermomagnetic electric field generation as a method of creating thermoelectric converters and highly sensitive magnetic field sensors	HORIZON-MSCA-2022-SE-01-01	BE		Aplikuar - Refuzuar	
24	03.05.2023	Bridging the Gap Developing Sustainable Entrepreneurship Curriculums and Mentorship Program for VET and HEIs to Foster Innovation Creativity and Economic Growth in Europe	ERASMUS-EDU-2023-PI-ALL-INNO-EDU-ENTERP	BE		Aplikuar - Refuzuar	



## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

25	23.06.2023	Kontrolli i sistemeve mekatronike me sinjale EEG të ndërfaqes Tru - Kompjuter/Control of mechatronic systems with the EEG signals of the Brain Computer Interface (MeKaEEG)	Projekte Bilaterale Shqipëri-Kosovë	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit AKKSHI	Albanian University - Universiteti i Prishtinës	<i>Aplikuar - në pritje të vlerësimit</i>	Sisteme Informatike dhe Teknologji në lidhje me kontrollin e sistemeve mekatronike me sinjale EEG të ndërfaqes Tru - kompjuter
26	23.06.2023	Studim mbi njohurite, Qendrimet dhe praktikat mbi përdorimin e antibiotikeve në kujdesin shëndetësor paqesor. Optimizimi i përdorimit të antibiotikeve për përballimin e krizës së antibioretistencës.	Projekte Bilaterale Shqipëri-Kosovë	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit AKKSHI	Albanian University - Kolegji AAB	<i>Aplikuar - në pritje të vlerësimit</i>	Projekt në kuadër të praktikave të mira rreth antibiotikeve në kujdesin shëndetësor paqesor.
27	20.09.2023	Toward a holistic support to children and adolescents' health and care provision in an increasingly digital society	HORIZON-RIA	BE		<i>Aplikuar - në pritje të vlerësimit</i>	



## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

Burimi i të dhënave të mëposhtme për pjesëmarrjen në Cost është sipas Formularit të vetëvlerësimit të pedagogëve realizuar nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike të plotësuar në fund të vitit akademik përkatës.

**Tabela 3**

	Viti akademik 2022-2023								
	Fakulteti i Shkencave Shoqërore			Fakulteti i Shkencave Mjekësore			Fakulteti i Shkencave të aplikuara dhe Ekonomike		
	DEA	DP	DSHJPA	DIF	DF	DS	DI	DAD	DE
Cost Member	2	1	3	0	3	2	19	2	0
MC member					1		9		
Science Communicator Cost							2		
						Total	32		

Një COST Action është një rrjet kërkimesh ndërdisiplinor që bashkon kërkues dhe inovatorë për të hetuar një temë të zgjedhur. COST Actions zakonisht përbëhen nga kërkues nga akademja, ndërmarrje të vogla dhe të mesme, institucione publike dhe organizata të tjera.

Në kuadër të 'Strategjisë së Kërkimit Shkencor 2021-2024', Albanian University ka nxitur pjesëmarrjen e stafit akademik përmes trajnimeve dhe aktiviteteve të dedikuara rreth COST të organizuara nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike.

Në vitin akademik 2022-2023 gjenden 32 pedagogë të stafit akademik në nivel institucional të përfshirë në thirrjet COST me shpërndarjen sipas njësisive bazë e kryesore në tabelën ilustruese.

**c) Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:**

**i) politikat e kërkimit shkencor;**

“Albanian University”, në fushat e studimit, kërkimit shkencor dhe të zhvillimit ka hartuar dhe ndjek një strategji e cila është në funksion të politikave tërësore të universitetit.

Universiteti ka një strukturë efektive, e cila përbëhet nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike dhe departamentet/Fakultetet. Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor është nën përgjegjësinë e një drejtuesi me gradë shkencore ose titull akademik.

Pranë Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor është ngritur Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimet, i cili drejton dhe orienton politikat e veprimtarisë botuese të Albanian University, ku përfshihet dhe revista shkencore “OPTIME”.

Aktiviteti në lëmin kërkimor shkencor i “Albanian University” bazohet, organizohet dhe zhvillohet në zbatim të ligjit Nr.80 / 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Senati i Universitetit me propozim të Zyrës së Koordinimit të





## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike miraton strategjinë bazë të kërkimit shkencor, strategji që shërben si rrëfyese për të tre Fakultetet e AU.

Kjo strategji përçohet në të gjitha departamentet dhe konkretizohet hollësisht në planifikime e zbatime specifike gjatë çdo viti akademik, me realizimin e kërkimit shkencor bazë ose të aplikuar; me studime e projekte për zhvillim, si dhe në veprimtari të tjera krijuese sipas objektivave të gjithësecilit, duke mbështetur veprimtarinë e stafit akademik për aftësimin dhe kualifikimin e tij jo vetëm në procesin e mësimdhënies, por edhe atë shkencor.

Në vijim, kërkohet të krijohet një raport i drejtë dhe efektiv midis mësimdhënies dhe kërkimit shkencor; të formohen shprehi të punës dhe të metodave kërkimore shkencore tek studentët, duke i aktivizuar ata deri edhe në përfshirjen e tyre në grupe studimore e projekte që kanë departamentet, fakultetet ose universiteti.

Politikat e “Albanian University” në fushën e kërkimit shkencor janë në funksion të misionit të institucionit dhe të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. Në këtë kuadër, Institucioni është i angazhuar të ndër marrë një sërë politikash, me qëllim zhvillimin e kërkimit shkencor, si më poshtë:

- Ngritja e strukturave institucionale në funksion të mbështetjes dhe nxitjes së kërkimit shkencor,
- Ngritja e kapaciteteve infrastrukturore në funksion të zhvillimit të kërkimit shkencor,
- Nxitja dhe fuqizimi i bashkëpunimeve me institucione homologe, biznese, qendra kërkimore dhe entite të tjera të angazhuara në kërkim shkencor, brenda dhe jashtë vendit,
- Integrimi në programe të ndryshme europiane si Erasmus+, CEEPUS, Horizon 2020, COST etj.,
- Nxitja e interesit dhe motivimi i stafit akademik dhe studentëve në drejtim të kërkimit shkencor.

**Objektivat strategjikë për zhvillimin e kërkimit shkencor konsistojnë në:**

- ❖ Forcimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të kërkimit shkencor bazë përmes temave të diplomave, detyrave dhe projekteve të studentëve etj.,
- ❖ Ngritjen e grupeve të mirëfillta kërkimore - shkencore në fusha të përafërta dhe me objektiva të përcaktuara qartë,
- ❖ Ngritjen e infrastrukturës së nevojshme për të realizuar kërkim - shkencor të aplikuar,
- ❖ Rekrutimin e vazhdueshëm të stafit me orientim kërkimor - shkencor,
- ❖ Pjesëmarrjen në projekte kërkimore - shkencore të mirëfillta kombëtare dhe ndërkombëtare,
- ❖ Zhvillimin e kërkimit shkencor për të tretët,  
Riorganizimin dhe hapjen e programeve të ciklit të tretë “Doktoratë” në përputhje me ligjin 80/2015 dhe aktet nënligjore në vazhdim të tij.  
Përmirësimin e vazhdueshëm të pjesëmarrjes në konferenca dhe publikimeve në revistatë stafit me produkte të kërkimeve shkencore gjithmonë e më cilësore,
- ❖ Ngritjen e revistës së Universitetit “Optime” në një revistë ndërkombëtare të indeksuar.



RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

**ii) të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien;**

Mësimdhënia në “Albanian University” është e lidhur ngushtë me kërkimin shkencor e reflektuar kjo me realizimin e studimeve apo projekteve kërkimore shkencore nga ana e stafit akademik. Rezultatet e studimeve bëhen objekt diskutimesh përgjatë orëve në auditor me studentët me qëllim motivimin e studentëve për t’u afruar me kërkimin shkencor, si dhe zhvillimi i detyrave të kursit, ku studentët zhvillojnë aftësitë e tyre mbi metodologjitë në kuadër të kërkimit shkencor. Gjithashtu, përgjatë vitit akademik organizohen konferenca shkencore studentore, ku studentët prezantojnë rezultatet e punëve shkencore të realizuara me mbështetjen e stafit akademik.

**iii) produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësia bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit**

**Tabela 4**

<b>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike (FSHAE)</b>		
<b>Veprimtaritë e zhvilluara nga departamenti Inxhinierive (DI)</b>		
<b>Konferenca</b>	<b>Leksione të hapura</b>	<b>Tjetër (Workshop, Tryeza të rumbullakëta, etj)</b>
Konferenca Ndërkombëtare “Intelligence - Transformations of Technology and Business” - 13 - 14.10.2022 - organizuar nga Instituti Kanadez i Teknologjisë - partner  ALBLAKES 4 - Konferenca Ndërkombëtare “Building Resilience of Éater Ecosystems Through Scientific Knoëledge” - 21 - 22.10.2022 - organizuar nga Universiteti i	Leksion i hapur në kuadër të projektit të përbashkët “Disenjimi dhe konstruktimi i dorës robotike të komanduar për lëvizje të ndryshme” - “Prezantim i rezultateve të fundit nga disenjimi dhe konstruktimi i dorës robotike”, Prof. Dr. Arbnor Pajaziti nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Kosovë - 31.01.2023.  Leksione me temë “Statistical methods for Engineering ëith applications” të mbajtura nga pedagogu Dr. Massimiliano Giacalone në vizitë në Albanian University në kuadër të programit të shkëmbimit Erasmus+ me Universitetin Vanvitelli, Itali - 08.05.2023 dhe 15.05.2023 (gjithsej 10 orë).	Vizita e studentëve të programeve të studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” dhe “Inxhinieri Elektrike” në TEC-in e Vlorës - 21.01.2023.  Vizita e studentëve të programeve të studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” dhe “Inxhinieri Elektrike” në Hidrocentralin e Fierzës - 25.03.2023.



RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" - partner	
--	--

**Veprimtaritë e zhvilluara nga departamenti Art-Dizajnit (DAD)**

Konferenca	Leksione të hapura	Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj.)
<p><b>Alblakes 4- International Conference on "Building Resilience of eater ecosystems through scientific knowledge"</b> 21-22.08.2022 Bashkë organizator në Konferencën ALBLAKES 4 - International Conference on "Building Resilience of Eater Ecosystems Through Scientific Knowledge", 21 - 22.10.2022. Elbasan, Albania</p>	<p>Leksion i hapur me ekspertin e dizajnit të paketimit <b>Susanne Lippitsch</b> "<i>Ehat a really good folding carton is all about, mbështetur nga Projekti ProCarton me Koordinatore Helena Schütte</i> 31.01.2023 (online)</p>	<p>Studentet e Departamentit të Art Dizajnit, në vijim të bashkëpunimit të Albanian University (AU) me Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit (AQSHF), morrën pjesë në seminarin dy ditor, 12 dhe 13 dhjetor 2022</p>
<p>Ekspozite Novelat grafike dhe Fabulat e autorit "Ezopi"</p>	<p>Leksion me fotografimin e njohur <b>Armand Sallabanda</b> me mbështetjen e profesor <b>Shpend Bengu</b>. 20.12.2022</p>	<p>Open day me Nxënësit e Gjimnazit "Qemal Stafa", Tiranë. Nën mbështetje e Profesor <b>Shpend Bengu</b>, 15.12.2022</p>
	<p>Leksion i hapur me Koordinatore <b>Helena Schütte</b> nga Projekti ProCarton, Student video aëard; young designers aëard. 20.12.2022</p>	<p>Prezantimi i Projektit b4students Balfin Group, nën kujdesin e Profesor <b>Shpend Bengu</b> 01.12.2022</p>
<p>Sesioni i dytë i seminarit në kuadër të projektit "<i>Për një rrjet institucionesh kulturore midis Pulias dhe Shqipërisë</i>" midis Fondazione Gramsci di Puglia dhe AQSHF-së do të zhvillohet në AQSHF në datat 12 - 13 Dhjetor 2022, orari 10.00 - 13.30 dhe 14.30-16.00. Ligjëratat u mbajtën nga prof. <b>Nicola Barbuti</b> nga <b>Dabimus srl</b>.</p>	<p>Në kuadër të projektit Resilience, përfaqësues të Komunitetit ortodoks, <b>Episkop Asti Ballakbashi</b> dhe Universitetit <b>Logos, Venian Mile</b>, 15.12.2022</p>	<p>"Në Berat, Duke u endur dhe skicuar", ark. <b>Andi Papastefani</b> - në "Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore", në Muzeun Etnografik Berat, bashkë organizues të eventit, 28.10.2022, Berat</p>



RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

	Leksionin e hapur on-line "Inteligjenca Artificiale + Design". Laboratori i Grafikës Artistike dhe Multimedias, DAD në "Albanian University" drejtuar nga Dr. Shpend Bengu, organizuan: Leksionin e hapur on-line "Inteligjenca Artificiale + Design" me artistin dhe dizajnerin e njohur shqiptar në SHBA Adrian Grezda, Creative Director.	Eksperiencia nga projektet ERASMUS Hert'ha Pataj, Elja Muça dhe studentë të AU 21.10.2022
	"Betëeen pattern and shadoë" me artistin Olson Lamaj. Këto ditë, me mbështetjen e Profesor Shpend Bengu, në auditorët e Albanian University, pranë Departamentit të Art Dizajnit, ishte i ftuar artisti shqiptar, Olson Lamaj, i cili prezantoi para studentëve projektin e tij të fundit fotografik "Betëeen pattern and shadoë".	Vizitë e studentëve të DAD, kryesisht të MP në "Interior Dizajn", të cilët me mbështetjen e Departamentit, u njohën nga afër me interieret e realizuara nga pedagogu i tyre Bashkim Zahaj, në një nga hotelet e bregdetit të qytetit të Vlorës. (6 qershor 2023)
<b>Departamenti i Shkencave Ekonomike</b>		
<b>Konferenca</b>	<b>Leksione të hapura</b>	<b>Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj.)</b>
	Digjitalizimi i shërbimeve bankare Dhjetor 2022 Prof. Bardhyl Ceku-Irida Huta	
	Risku rregullativ për bankat Janar 2023 Prof. Bardhyl Ceku-Elona Bollano	
	Implikimet menaxheriale në modelet reja të të bërit biznes Mars 2023 Prof. As Manuela Mece	
	Ndryshimet kulturore dhe ndikimet në zhvillimin e veprimtarive në biznesin ndërkombëtar Prill 2023 Prof. Bardhyl Ceku-Mirela Bregu	
	Market and Liquidity Risk Management (Banking Practice)  Maj 2023 Dr. Fatmira Kola, Eralda Korvafaj	



## RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

	Cikli i jetës dhe implikimet nezhvillimin ekonomik Maj 2023 Prof Bardhyl Ceku- Massimilino Giacolone	
<b>Fakulteti i Shkencave Mjekësore</b>		
<b>Veprimtaritë e zhvilluara nga departamenti Stomatologjisë</b>		
Konferenca	Leksione të hapura	Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj.)
<p>30-31 Mars 2023 - Konferenca e 19-të Ndërkombëtare e Stomatologjisë "Zhvillimet e reja të teknologjisë në fushën e shkencave dentare dhe të kujdesit oral"</p> <p>5-7 Maj 2023 - Kongresi Kombëtar i Shkencave Mjekësore 11.</p> <p>14-16 Shtator 2023- Kongresi i 5-të Ndërkombëtar: "Innovazioni tecnologiche e protocolli sperimentali in Parodontologia, Chirurgia Orale e Ortognantodonzia" Bari, Itali</p>	<p>01 Tetor 2022 - Përfitimet e Laserit në fushën Dentare</p> <p>18 Nëntor 2022 Leksion i hapur me temë: "Emuloni natyrën: nga vëzhgimi te zbatimi i përditshëm" nga Djemal Ibraimi.</p> <p>7 Dhjetor 2022- Leksion i hapur me temë: "Koncepte themelore mbi përgatitjen e Temës së Diplomës" nga Dr. Loreta Pojani.</p> <p>31 Mars 2023 - Leksion i hapur "Restaurimet adezive në protetikën fikse, materiale dhe procedura" nga ODT Francesco Ferretti</p> <p>13 Prill 2023 - Leksion i hapur "Përpunimi statistikor në fushën e mjekësisë" nga Dr. Elida Mata</p> <p>8-9 Maj 2023 Leksione të hapura "Statistical methods for Medicine ëith applications" nga Ph.D. Massimiliano Giacolone, Vanvitelli University, Italy i Biomaterialet, nga PhD. Demet Erdag. (Projekt Erasmus)</p>	<p>17-18 Tetor dhe Nëntor 2022, trajnim në Implantologji (edukim në vazhdim)</p> <p>08 Janar 2023 Trajnim "BLS&amp;D, Guideline-et e reja nga AHA 'American Heart Association' " nga Qendra Kombëtare e Urgjencave Mjekësore.</p> <p>Trajnim i modelimit të porcelanit nga Enzo Casale, në ëorkshopin e organizuar në datat 25-26-27 Maj 2023, gjatë Kongresit IDEX, Turqi</p>
<b>Veprimtaritë e zhvilluara nga Departamenti i Farmacisë</b>		
Konferenca	Leksione të hapura	Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj.)
Konferenca Ndërkombëtare në Shkenca Farmaceutike VIII (ICPS VIII)		23.11.2022 Tema "Përgatitja e Temës së Diplomës për Punime të Kërkimit



RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

		<p>Shkencor dhe Epidemiologjike" (D. Xhafaj)</p> <p>05.12.2022</p> <p>"Metodat e avancuara të Kërkimit Shkencor" (E. Mataj)</p> <p>07.04.2023</p> <p>Massimiliano Giacalone " Rëndësia e përpunimit statistikor në shkencat e shëndetit.</p>
<b>Veprimtaritë e zhvilluara nga departamenti Infermierisë &amp; Fizioterapisë</b>		
<b>Konferenca</b>	<b>Leksione të hapura</b>	<b>Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj.)</b>
<p>27.04.2023</p> <p>Semundshmeria kronike, sfide madhore e mjekesise bashkekohore.</p>	<p>09.06.2023</p> <p>Teknologjia modern rehabilitimi ne qendren romaten dhe mundesi punesimi per te rinjt. Phd Proc. Fatjon Hajdari &amp; Merve Akinoglu.</p> <p>30.05.2023</p> <p>Ndikimi I rrezatimit ne personelin shendetesor. Dr. Svetllana Bitincka.</p> <p>19.01.2023</p> <p>Linfodrenazhi ( teori/praktike). SPa. Etleva Strati, Student Esmeralda Scheffknecht.</p> <p>10.01.2023</p> <p>Hematopoeza, gjaku periferik, hemostaza, anemia deficitare, grupet e gjakut. Dr. Sotir Lako &amp; Dr. Svetllana Bitincka</p> <p>20.12.2023</p> <p>Sporti dhe fizioterapia. MSc. Muhamet Ostreni.</p> <p>20.12.2022</p> <p>Infeksioni Hiv/AIDS, Ecuria dhe parandalimi I tij. Dr. Svetllana Bitincka/Marjeta Dervishi</p> <p>13.12.2022</p> <p>Pervoja praktike infermieristike, sfide per studentet e Infermierise ne AU. Prof.Asoc.Dr. Edmond Laho</p>	<p>20 Korrik 2022</p> <p>Open Day</p> <p>Master Profesional "Terapi Manuale" dhe "Infermieri irurgjikale"</p>



RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

Fakulteti i Shkencave Shoqërore		
Veprimtaritë e zhvilluara nga departamenti Edukimit dhe Anglishtes		
Konferenca	Leksione të hapura	Tjetër (Workshop, Tryeza të rrumbullakëta, etj.)
<p><b>11 Maj 2023</b> - Konferenca shkencore "Quality education for all", Fakulteti i Shkencave Shoqërore në bashkëpunim me University College of Teacher Education in Vienna</p>	<p align="center"><b>21.11.2011</b></p> <p>"Albanian University" në kuadrin e mbështetjes së Panairit të Librit, si dhe në kuadër të kontributit për promovimin e veprave dhe autorëve me cilësi, zhvilloi aktivitetin kushtuar shkrimtarit të njohur Xhevahir Lleshi duke promovuar 4 nga veprat e shkrimtarit, përkatësisht romanet "Tala", "Telekat", "Tërbimi" dhe "Brenga".</p> <p align="center">Leksion i hapur 10.11.2022</p> <p>AU dhe Ambasada e Republikës së Çekisë në Tiranë</p> <p>Pervoja e Çekisë për në BE, Presidenca e BE dhe sfidat për Shqipërinë</p> <p>Studentët e Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në "Albanian University" më datë <b>09.11.2022</b>, u bënë pjesë e leksionit të hapur për "Aftësimin në media dhe në Informacion" të zhvilluar posaçërisht nga Biblioteka Kombëtare Shqiptare</p> <p>Studentë dhe kërkues shkencorë të Fakultetit të Shkencave Shoqërore dhe Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, në kuadër të infrastrukturës kërkimore RESILIENCE në të cilën "Albanian University" është partner.</p> <p><b>3 Prill 2023</b> - Orë mësimore e hapur nga studentët e Erasmus + Luiza Spahiu dhe Kiara Mishi, DEA</p> <p><b>18 Prill 2023</b> - Ditët informuese Projekte të Teknologjisë dhe Inovacionit</p> <p><b>3 Maj 2023</b> - Webinar "Codex Purpureus Beratinus" in Unesco's - Prof.Dr. Shaban Sinani</p>	<p>Në kuadër të infrastrukturës kërkimore shkencore europiane RESILIENCE, "Albanian University" në bashkëpunim me Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe Kolegjin Universitar "LOGOS", zhvilluan aktivitetin me temë "Krishtërimi Orthodhoks në Shqipëri në 20 shekuj"</p> <p>Shqiptarët dhe hebrenjtë në Luftën e Dytë Botërore</p> <p><b>26.01.2023</b></p> <p>Vizitë studentore Akademia e Shkencave e Shqipërisë</p> <p>Erasmus Day - në Albanian University Ërkshop <b>14.10.2022</b></p> <p>Vizitë studentore <b>10.11.2022</b></p> <p>Biblioteka kombëtare</p> <p>Vizitë studentore <b>14.11.2022</b></p> <p>Biblioteka kombëtare - Ekspozita "Udhëtarët francezë në Ballkan e Orient"</p> <p>Vizitë studentore</p> <p>Kryegjyshata Botërore Bektashiane <b>16.11.2022</b></p> <p>Nën kujdesin e Kryetares së Kuvendit, znj. Lindita Nikolla, në kuadrin e ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore, me nismën</p>



RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

	<p>5 Maj 2023 - Ditët informuese për thirrjet nga AKKSHI</p> <p>9 Maj 2023 - Leksion i hapur "Dita e Europës"</p>	<p>e Institutit Parlamentar, Kuvendi organizoi veprimtarinë "Zbatueshmëria dhe përmirësimi i legjislacionit mbi dhunën me bazë gjinore"</p> <p><b>09.12.2022</b></p> <p>Kuvendit të Shqipërisë</p> <p>Studentët e Departamenteve të Edukimit dhe Anglishtes dhe Psikologjisë së Përgjithshme të "Albanian University" marrin pjesë në kuadrin e veprimtarive kushtuar 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe "në ditën e katërt në "Ditët e drejtshkrimit", me temë: "Shqipja e njësuar dhe të folmet arbëreshe" organizuar nga Qendra për Hapje dhe Dialog (COD) në Bibliotekën e Kryeministrisë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.</p> <p>Si të promovojmë punën shkencore <b>07.10.2022</b></p> <p>22 qershor 2023 Ekspozita "Të mësuarit përmes artit", Dr. Eli Xoxa, studentët e programeve të Bsc. Mësuesi për Arsimin Fillor dhe Bsc. Mësuesi për Arsimin Parashkollor</p>
<b>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme</b>		
<b>Konferenca</b>	<b>Leksione të hapura</b>	<b>Tjetër (Workshop, Tryeza të rumbullakëta, etj.)</b>
	<p>Dr. Elisabeta Kafia dhe një grup pedagogësh, mirëpritën UN Eomen në Shqipëri dhe Organizatën Botërore të Shëndetësisë në një leksion të hapur në kuadrin të fushatës 16 ditore të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore, nën sloganin ndërkombëtar: <b>AKTIVIZOHU PËR TI DHËNË FUND DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE 13.12.2022</b></p>	<p>Qendra Equilibrium në kuadrin të marrëveshjes së bashkëpunimit me Departamentin e Psikologjisë, zhvilloi trajnimin mbi Crregullimin e Spektrit të Autizmit dhe ndërhyrjen e terapisë</p>





RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

	<p><b>Leksion i hapur</b>                  Droga dhe pasojat te fëmijët                  Maj 2023 Pedagoge Jonida Haxhiu</p>	<p>Psikomotore.Me studentët e Prgrameve Bachelor dhe Master.                  10.03.2023</p> <p>Në kuadër të infrastrukturës kërkimore shkencore europiane RESILIENCE, “Albanian University” në bashkëpunim me Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe Kolegjin Universitar “LOGOS”, zhvilluan aktivitetin me temë “Krishtërimi Orthodhoks në Shqipëri në 20 shekuj”</p> <p>Nën kujdesin e Kryetares së Kuvendit, znj. Lindita Nikolla, në kuadrin e ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, me nismën e Institutit Parlamentar, Kuvendi organizoi veprimtarinë “Zbatueshmëria dhe përmirësimi i legjisllacionit mbi dhunën me bazë gjinore”                  09.12.2022                  Kuvendit të Shqipërisë</p> <p>Instituti Parlamentar i Kuvendit të Shqipërisë në bashkëpunim me “Albanian University”, Fakultetin e Shkencave Shoqërore në kuadër të takimeve dhe kumtesave të 110 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, më datë <b>1 dhjetor 2022</b> zhvilluan aktivitetin kushtuar : “100 Vjetorit të Krijimit të Statutit të Zgjeruar të Lushnjes”</p> <p>Si të promovojmë punën shkencore                  07.10.2022</p>
Departamenti I Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative		
Konferenca	Leksione të hapura	Tjetër (Workshop, Tryeza të rumbullakëta, etj.)



RAPORT VJETOR VITI AKADEMIK 2022-2023

	<b>10.11.2022</b> Përvoja e Cekisë për në BE, Presidenca e BE dhe sfidat për Shqipërinë	<b>21.11.2022</b> Promovim 4 veprat e shkruarit Xhevahir Lleshi <b>25.02.2023</b> Fuqizimi i Integritetit të Zgjedhjeve dhe i Qendrueshmerise se Partive Politike <b>15.03.2023</b> Dixhitalizimi i Inventarit të Fondit të Arkivit Shtetëror
--	--	---

Veprimtaritë e zhvilluara nga studentët v.a 2022-2023

Tabela 5

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike		
Konferenca	Aktivitete ekstrakurrikulare	Tjetër
